



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:203085

Datë: 26.12.2019

Numri i dokumentit: 00736181

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.984/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi dhe zyrtaren ligjor te kësaj gjykate Lavdije Brahimi Aliu në çështjen penale kundër të pandehurve A.K për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par 1 të KPRK-së. Sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. Nr.1595-3/19 e datës 13.09.2019 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 10.12.2019 në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurores së Shtetit Sebahate Sinani dhe të pandehurit A.K, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me date 26.12.2019 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.K nga i ati I...nëna H....., e vajzërisë N....., i lindur në Ferizaj me date, me vendbanim në Ferizaj në rr.”...” nr.40, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtoare fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i dy fëmijëve shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Me date 13 gusht 2019 rreth orës 18:00 në restorant “Kosova” në rrugën “.....” Ferizaj, pas një mosmarrëveshje verbale për një vend në tavolinë në restorantin e lart cekur, i pandehuri me qëllim të frikësimit e kanos seriozisht të dëmtuarin B.B me fjalët se “ka me të vra a e din ti kush jam unë”

me të cilën ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës ligjore të sipër cekur si dhe dispozitave ligjore nga neni 81 dhe 82 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton

VËREJTJE GJYQËSORE

- I pandehuri A.K u njoftua se vepra e tillë përbën vepër penale, vepër e dëmshme dhe e rrezikshme, si dhe nëse i njëjti prap kryen vepra të tilla gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.
- I dëmtuari B.B nga Ferizaj rr.”.....” për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën e saj Ferizaj PP/II. Nr.1595-3/19 e datës 13.09.2019 ka ngarkuar të pandehurin A.K me vendbanim në Ferizaj rr.”.....”, për veprën penale me të cilën ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par 1 i KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me date 10.12.2019 në të cilin shqyrtim gjyqësor i pandehuri është deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj dhe se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, jam i penduar thellë, duke shtuar se me te dëmtuarin ne kemi folur dhe kemi pasur raporte të mira, është hera e pare që bie ndesh me ligjin, e lus gjykatën që të me shqiptoj një dënim sa me te bute dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsërisë vepra të tjera penale.

Prokurorja e shtetit Sebahate Sinani nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri meqë një pranim i tillë është bërë është bërë konform dispozitave ligjore nga neni 248 të KPK-së pra në mënyrë vullnetare nga i cili pranim ka mbështetje në të gjitha provat dhe shkresat që përmban aktakuza, i propozoj gjykatës që të ketë parasysh pranimin e fajësisë.

Pasi që i pandehuri kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 4 të KPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se

- E pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- Pranimi është bërë vullnetarisht;

- Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe ate me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht si dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale e kryer, është mbajtës i familjes dhe se nuk është e evidentuar më parë si kryes i veprave penale, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese. Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në harmoni me peshën e veprës penale, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar me kusht se do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/€, në afatin prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata konform nenit 458 e 463 të KPPRK-se vendosi që të udhëzoj të dëmtuarin në kontest civil.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë conform nenit 39 par 3 pika 3.1, nr.05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e lartë cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

P.nr.984/19 të dates 26.12.2019

Zyrtare Ligjore:

Lavdije Brahim Aliu

Gjyqtarja:

Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Gjykatës së Apelit të Kosovës. Ankesa I dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.